



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

---

Kom.Dh.Shk.II.nr.41/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit A... L.L.C, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ardi Shita, avokat nga Prishtina, kundër debitorit E....sh.p.k, me seli në Pejë, e përfaqësuar nga A.L. Drejtor i Përgjithshëm, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me Propozimin e kërkesës së kreditorit për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës Ac.nr.1780/2019 të datës 16.12.2019, jashtë seancës, me datën 03.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet Kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme-për pranimin e ankesës si të afatshme, të paraqitur nga kreditori A... L.L.C, me seli në Prishtinë, të paraqitur në Gjykatë me datën 23.01.2020, ndaj Aktvendimit Ep.nr.133/2018 datës 04.03.2019 të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm-Civil.

Abrogohet Aktvendimi Ac.nr.1780/2019 datës 16.12.2019 i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, dhe çështja kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhet para nxjerrjes së Aktvendimit Ac.nr.1780/2019 dt.16.12.2019 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është Hudhur si e palejueshme ankesa e kreditorit

A R S Y E T I M

Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr.1780/2019 të datës 16.12.2019, ka vendosur të Hedh poshtë si të pa lejuar ankesën e kreditorit A... L.L.C, me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë –Departamenti i Përgjithshëm EP.nr.133/2018 të datës 04.03.2019, me arsyetim se ankesa e kreditorit është e palejueshme.

Kreditori A... L.L.C, me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 23.01.2020 në Gjykatë ka paraqit Kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme të lëndës Ac.nr.1780/19, ashtu që prishet Aktvendimi Ac.nr.1780/19 dt.16.12.2019, dhe Lënda Ep.nr.133/18 Rivendoset sipas ankesës së kreditorit dt.14.03.2019. Ankesa e dorëzuar nga kreditori me datën 14.03.2019 është dorëzuar përmes postës se Kosovës me letër Rekomand, e kjo dëshmohet me letër Rekomande me numër serik te pranimit 7097910 e vulosur nga Posta e Kosovës me datën 14.03.2019. me dorëzimin e ankesës përmes Postës së Kosovës, kreditori e kishte dorëzuar

ankesën brenda afatit ligjor prej 7 ditësh. Është normale që ankesa ka arritur disa ditë më vonë në Gjykatën Themelore të Pejës, megjithatë një veprim të tillë i kreditorit është në përputhje të plotë me dispozitën ligjore të nenit 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore lidhur me dispozitën ligjore të nenit 127 (2) të Ligjit 03/L-006 për Procedurën Kontestimore. Përkundër dorëzimit të ankesës brenda afatit ligjor, rezultojnë që Gjykata Themelore në Pejë me rastin e dërgimit të dosjes ë lëndës në Gjykatën e Apelit për vendosje sipas ankesës së kreditorit, nuk e ka dorëzuar edhe dëshminë (zarfin) në të cilin është shënuar vulosur edhe data se kur palakreditori e ka dorëzuar ankesën. Në një situatë të tillë, ku gjykata shkalles së parë duke mos dorëzuar në shkresë të lëndës edhe dëshminë e Postës me datën e dorëzimit të ankesës në Postë, i ka humbur kreditorit të drejtën e ankimit ndaj vendimit Ep.nr.133/18 pasi që Gjykata e Apelit në mungesë të një prove të tillë nga Posta, e ka konsideruar ankesën e kreditorit si të palejueshme për shkak të skadimit të afatit për dorëzim të ankesës.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, pasi ka shqyrtuar kërkesën e kreditorit për kthim në gjendjen e mëparshme dhe të gjithë dokumentacionin e shkresave të lëndës, vlerëson se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që të aprovohet Kërkesa e kreditorit për kthim në gjendjen e mëparshme, për arsye se kreditori ka dëshmuar me prova se ka parashtruar ankesën brenda afatit ligjor.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se kreditori me Kërkesën për kthimin e gjendjes së mëparshme ka bashkangjitur Dëftesën e pranimit të dërgesës e lëshuar nga Posta e Kosovës në Prishtinë, e datës 14.03.2019, me numër serik të pranimit 7097910 e vulosur nga Posta e Kosovës, dhe si marrës në këtë Dëftesë rezultojnë të jetë Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm-Civil.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi nga shkresat e lëndës, se me datë 07.03.2019 i autorizuari i kreditorit, ka pranuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm EP.nr.133/2018, (provë: flet kthesa e pranuar nga i autorizuari i kreditorit dt.07.03.2019), ndërsa ankesa e dorëzuar përmes postës ka datën 14.03.2019, që nënkupton se ankesa është paraqitur nga kreditori brenda afatit ligjor prej 7 ditësh. Kjo gjykatë, në kuptim të rrethanave të paraqitura më lart gjen se ankesa e kreditorit është e lejueshme pasi që me dispozitën e nenit 77 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se: “Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit”,

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se në vështrim të nenit 129 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 shprehimisht parashihet se: “Kur lejohet kthimi në gjendje të mëparshme procesi kontestimor kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para mosveprimit dhe prishen të gjitha vendimet që i ka dhënë gjykata për shkak të mosveprimit”, andaj në kuptim të kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë pasi që aprovoj kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme, e prish Aktvendimin Ac.nr.1780/2019 datës 16.12.2019 i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, dhe çështja kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para Aktvendimin Ac.nr.1780/19.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga këto fakte, bazuar në kërkesën propozimin e përfaqësuesit të kreditorit për kthim në gjendje të mëparshme, gjeti se kërkesa e kreditorit është e arsyeshme, andaj vendosi që të lejohet kthimi në gjendje të mëparshme.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 129 par.2 e lidhur me nenin 133.3 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË  
Dhoma e shkallës së dytë  
Kom.Dh.Shk.II.nr.41/2022 me datën 03.11.2022

Gjyqtari  
Krenar Berisha